



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2022:169265

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05279664

Numri i lëndës: 2023:193282

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05171918

P.2022:169266

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, me Bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurve E.M, për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale tentativa në kryerjen e veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurve L.S, F.S, B.K për shkak të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28, 33 dhe 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 1173/22 të datës 17.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 16.01.2024, në seancë publike, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurve mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I Pandehuri E. M me vendbanim në rrugën "...", Lagjja ... -Prishtinë i lindur më .., nga i ati Xh..dhe e ëma E... e gjinisë S..., me numër personal ..., i martuar, baba i 1 fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

II. I Pandehuri L. S. nga Fshati ..., Komuna e Vushtrrisë i lindur më datë ..., nga i ati S... dhe e ëma F... e gjinisë S..., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon biznes privat, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

III. I Pandehuri F.S me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Obiliqit i lindur më datë ..., nga i ati F...dhe e ëma N... e gjinisë T..., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni M..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

IV. I Pandehuri B. K. me vendbanim në rrugën "...", Komuna e Obiliqit i lindur më datë ..., nga i ati A... dhe e ëma Sh... e gjinisë K..., me numër personal ..., i martuar, baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

## JANË FAJTOR

I pandehuri E.M:

I

Me datë 03.08.2022, rreth orës 15:30, i pandehuri me dashje ka kaluar vijën kufitare Republika e Kosovës - Republika e Maqedonisë Veriore, në atë mënyrë që pasi nuk ishte lejuar të kaloj kufirin nga zyrtarët policor sepse nuk kishte me vete asnjë dokument identifikimi, i njëjti zbret nga vetura e markës "...", ngjyrë e kaltër metalike, me targa ..., në të cilën ishte së bashku me L.S, F.S dhe B.K., kalon kufirin në mënyrë ilegale dhe takohet me të njëjtit në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së

## II.

I pandehuri E.M:

Me datë 03.08.2022, rreth orës 21:50, i pandehuri me dashje tenton të kalojë nëpër kufirin Republika e Maqedonisë Veriore – Republika e Kosovës, në atë mënyrë që pasi që nuk kishte me vete asnjë dokument identifikimi futet në bagazhin e veturës ..., ngjyrë e kaltër metalike, me targa ..., të cilën ishte duke e vozitur L.S, ndërsa pasagjerë ishin B. K. dhe F.S, i cili pas një kontrole të veturës haset nga zyrtarët doganor.

Me këto veprime ka tentuar të kryej veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3 nën paragrafi. 3.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së

## III.

Të pandehurit L.S, F.S dhe B. K.:

Me datë 03.08.2022, rreth orës 21:50, të pandehurit pas një marrëveshje paraprake me dashje tentojnë të ndihmojë të pandehurin E.M të kalojë nëpër kufirin Republika e Maqedonisë Veriore – Republika e Kosovës, në atë mënyrë që pasi i njëjti që nuk kishte me vete asnjë dokument identifikimi futet në bagazhin e veturës ..., ngjyrë e kaltër metalike, me targa 04-603-GS, të cilën ishte duke e vozitur L.S, ndërsa pasagjerë ishin B.K dhe F.S, të cili pas një kontrole të veturës hasen nga zyrtarët doganor.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë tentuar të ndihmojë të kryej veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28, 33 dhe 31 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364, 452, 462 të KPPK-së, të pandehurit i:

## GJYKON

1.1. Të pandehurin E. M për pikën I të dispozitivit i cakton dënim me gjobë në shumë në shumë 250€.

1.2. Të pandehurin E. M për ikën II të dispozitivit i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 350 (Treqind e pesëdhjetë euro) €.

Konform nenit 76 par 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurin E.M e:

## GJYKON

I. Me dënim unik me gjobë në shumë prej 600.00€ (Gjashtë qind euro), të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 3 (tre) këste mujore të barabarta, në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20€ (njëzetë euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

2. Të pandehurin L. S. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 250 (Dyqind e pesëdhjetë euro) €, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 2 këste mujore të barabarta, në afat prej 2 muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast mos pagese, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste (rata) do të revokohet.

3. Të pandehurin F.S me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 250 (Dyqind e pesëdhjetë euro) €, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 2 këste mujore të barabarta, në afat prej 2 muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast mos pagese, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste (rata) do të revokohet.

4. Të pandehurin B.K me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 250 (Dyqind e pesëdhjetë euro) €, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 2 këste mujore të barabarta, në afat prej 2 muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast mos pagese, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste (rata) do të revokohet.

5. Obligohen të pandehurit secili veç e veç, që për shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën nga 30€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit secili veç e veç të paguaj shumën nga 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, të pandehurve E.M, për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së dhe për tentim kryerjen e veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurve L.S, F.S, B.K për shkak të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28,33 dhe 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 1173/22 të datës 17.08.2022

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 16.01.2024

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, të pandehurit secili veç e veç e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, kanë deklaruar se janë penduar për veprimet e kryera, dhe i kanë premtuar gjykatës që nuk do të përsërisin vepra penale në të ardhmen, dhe kanë dhënë pëlqimin për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve, dhe ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë me të cilën janë akuzuar sipas aktakuze pasi që të njëjti bërën pranim vullnetar dhe një pranim i tillë ka mbështetje në provat që i përmban kjo aktakuzë dhe po ashtu është në pajtim me dispoziten e nenit 242 të KPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë për të pandehurit, Gjykata me caktimin e llojit të dënimit në kuptimi të nenit 69 të KPRK-së, të merr pranimin e fajit ndërsa si rrethana rënduese të marrë shkallen e përgjegjësisë penale motivet për kryerjen e veprës penale si dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, të njëjtëve t'ju shqiptohet një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenin 38 të KPRK-së

#### *Vlerësimi i pranimi të fajësisë*

Pasi që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, në fillimin e shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin figurës së veprës penale gjykata konstatoi se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të pandehurit E.M, për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga

neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së dhe për veprën penale tentim kryerjen e veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurve L.S, F.S, B.K për shkak të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 lidhur me nenin 28,33 dhe 31 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### *Rrethanat për matjen e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin E.M, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarimin se është penduar për veprimet e kryera, premtimin e tyre se nuk do të përsërit vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata gjeti se i njëti brenda të njëjtës ditë e ka përsëritur veprën penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin L.S, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarimin se është penduar për veprimet e kryera, premtimin se nuk do të përsërit vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin F.S, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarimin se është penduar për veprimet e kryera, premtimin se nuk do të përsërit vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin B.K, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarimin se është penduar për veprimet e kryera, premtimin se nuk do të përsërit vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurit iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të parapara në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata vendimin mbi shpenzime të procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-së.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242, 364 dhe 462 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P.2022:169266, datë 02.02.2024

Procesmbajtës:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.